

NJOFTIM TAKSAPAGUESVE INDIVID/BIZNES

Ju njoftojme se në zbatim të ligjit nr. 86/2025 “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe detyrimeve të pagueshme në doganë” dhe Udhëzimit nr. 11 date 14.05.2026 të Ministrit të Financave, është vendosur si më poshtë:

- **Detyrimet deri më 31.12.2014:** Fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2015–2019:** Mund të përfitoni nga shuarja e pjeshme/me kusht, sipas zgjedhjes suaj:
 - 50% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 50% brenda datës **30.06.2026**.
 - 25% e detyrimit fshihet, nëse paguani pjesën tjetër 75% brenda datës **31.12.2026**.
 - Në të dyja rastet, gjobat dhe kamatëvonesat fshihen plotësisht.
- **Detyrimet për periudhën 2020–2024:** Fshihen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që të paguhet 100% i principalit deri më **31.12.2026**.

Afatet dhe të drejtat tuaja:

- Ky vendim ka efekt deri më **31.12.2026**.
- Nëse nuk përmbushni kushtet e pagesës brenda afateve, nuk përfitoni nga fshirja/shuarja.
- Ju keni të drejtë të ankoheni pranë gjykatës administrative, sipas legjislacionit në fuqi.